



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT
KRYETARI

Nr. 888 prot.

Tiranë, më 01.08.2024

URDHËR

Nr. 175, datë 01.08.2024

“Për pezullimin e procedurave të shortit gjatë periudhës së lejes vjetore”

Bazuar në nenin “C”, pika 3 të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 13, gërma “d” të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nenin 18 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenin 7 të rregullores “Për veprimtarinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit të Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar, si dhe në nenin 3 të rregullores “Për procedurat e zhvillimit të shortit manual në Kolegjin e Posaçëm të Apelit”, për shkak të lejes vjetore të gjyqtarëve të Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

URDHËROJ:

1. Pezullimin e procedurave të hedhjes së shortit për ankimet/kërkesat e regjistruara në kuadër të Juridiksionit të Rivlerësimit dhe në kuadër të Juridiksionit Disiplinor në Kolegjin e Posaçëm të Apelit për periudhën nga data 05.08.2024 deri më 09.09.2024¹.
2. Drejtoria e Menaxhimit të Çështjeve dhe Marrëdhënieve me Median dhe Publikun dhe Drejtoria Ekonomike dhe e Shërbimeve Mbeshtetëse të marrë masat për protokollimin, verifikimin, pranimin dhe regjistrimin e ankimeve/kërkesave në regjistrat përkatës, në kuadër të Juridiksionit të Rivlerësimit dhe në kuadër të Juridiksionit Disiplinor në Kolegjin e Posaçëm të Apelit për periudhën nga data 05.08.2024 deri më 09.09.2024.
3. Një kopje e këtij urdhri t’i komunikohet Drejtorisë së Menaxhimit të Çështjeve dhe Marrëdhënieve me Median dhe Publikun, Drejtorisë Ekonomike dhe të Shërbimeve Mbeshtetëse, si dhe Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit.
4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm me ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI


Sokol Çomo



¹ Data 09.09.2024 nuk përfshihet në afatet e pezullimit.